



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 950/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
  1. *Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikim, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 180 studentë për vit akademik,
- II. **Riakreditohet** programi i studimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
  1. *Menaxhment Ndërkombëtar, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 200 studentë për vit akademik,
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikim BSc, 180 ECTS, Ri akreditim	Arsim Susuri Ercan Canhasi Zirije Hasani
2.	Menaxhment Ndërkombëtar, BSc, 180 ECTS, Riakreditim	Hamdi Hoti Demir Lima Drita Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren me këtë përbërje: Drazen Vrhovski, Sasa Aksentijevic, Damir Kalpic dhe Giga Khositashvili. Vizita është organizuar më 14.04.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacioni, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) standarde dhe substancialisht pesë (5) standarde.
- Për programin e studimit *Menaxhment Ndërkombëtar, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) dhe substancialisht tri (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dy.  Hajrija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

